



KPMG Albania Shpk Dega në Kosovë
Rruga "Sulejman Vokshi"
Nr.14
Prishtinë ,Kosovë

Telefon +381(38)246771
Faks +381(38)246772
E-mail al-kosovo@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Nr. i Dokumentit: KPMG 2014/7

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITIN E
PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, Qershor 2014

*Pasqyrat financiare të Komunës i janë bashkëngjitur këtij raporti.

KPMG ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Kaçanikut ('Komuna') për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013, në emër të zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni i ZAP-it është që "të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike."

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia.....	7
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm.....	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak	16
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	17
5 Sistemi i auditimit të brendshëm	27
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara	28
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	30
Shtojca III: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave tona.....	32

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

KPMG ka kryer auditimin e pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Kaçanikut ('Komuna') për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013, në emër të zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave financiare vjetore (PVF-të) për vitin 2013 - i cili e përcakton Opinionin e Audituesve. Ne do të donim të falënderonim Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2013 u ndërmor në përputhje me Parimet dhe Udhëzimet Themelore të Auditimit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ('ONISA' ose 'INTOSAI'). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të muajit tetor 2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- PVF - pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për PVF-të të theksuara në Memon e Planifikimit të Auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj Rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Komunës (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit)

Niveli i punës së kryer për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara.

Opinionin ynë është paraqitur në pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shënim: Opinionin është një pasqyrim i të gjeturave të auditimit të theksuara në këtë raport.

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në pjesët e këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Menaxhmenti i Komunës ka projektuar dhe zbatuar një sistem të kontrolleve të brendshme. Megjithatë disa kontrole mbi fusha kyçe të administrimit dhe raportimit financiar nuk ishin zbatuar dhe nuk operonin në mënyrë efektive. Në veçanti, ne identifikuam dobësitë e mëposhtme:

- Gjatë viteve të fundit, Komuna ka adresuar vetëm pjesërisht rekomandimet tona lidhur me Nenin 16 Shpalosja e pasurive dhe pagesat nga palët e treta, dhe rrjedhimisht kjo fushë vazhdon të paraqesë një rrezik domethënës. Si pasojë e natyrës së regjistrimeve bazë dhe mungesës së dokumentave mbështetës ekzistojnë disa pasiguri lidhur me të drejtat e pronësisë, plotësinë dhe vlerësimin e pasurive, objekteve dhe pajisjeve;
- Gjithashtu, Komuna ka adresuar vetëm pjesërisht rekomandimet tona të tjera nga vitet e shkuara. Komuna nuk ka një ndërtuar një proces të fortë që do të siguronte zbatimin e plotë dhe në kohë të rekomandimeve tona;
- Të hyrat aktuale vetanake janë realizuar në nivelin 67% të buxhetit për vitin 2013, dhe janë ulur me 5% krahasuar me të hyrat për vitin 2012. Ekzekutimi i ulët i buxhetit është nga fushat kryesore ku nevojiten përmirësime;
- Komuna ende nuk ka një sistem automatik faturimi për të gjitha llojet e te hyrave vetanake dhe llogarive të arkëtueshme lidhur me to;
- Ne kemi identifikuar një numër mospërputhshesh me Ligjin Nr. 04L-042 “Ligji i Prokurimit Publik në Kosovë” (i ndryshuar). Mospërputhje të tilla janë të lidhura me procedurat e kërkuara të cilat Komuna nuk i ka kryer dhe dokumentuar;
- Free Balance nuk siguron plotësi të informacionit të kërkuar për qëllime të raportimit financiar dhe nuk mund të përdoret i vetëm për të gjeneruar pasqyra të plota financiare. Edhe pse PVF-të kishin adresuar shumicën e kërkesave për prezantim, PVF-të e paraqitura për auditim kishin disa lëshime dhe pasaktësi. Disa janë ndryshuar në versionin final të PVF-ve, por disa zëra mbeten të pakorrigjuar, siç paraqiten në pjesën 2.3 të këtij dokumenti; dhe
- Komuna nuk ka marrë masa të mjaftueshme për sigurimin e pavarësisë së Komitetit të Auditit nga manaxhmenti.

Rekomandimet tona kryesore janë që Kryetari:

- Të analizojë arsyet për pasiguritë lidhur me pasuritë, objektet dhe pajisjet dhe të identifikojë veprimet që nevojiten për të adresuar këtë çështje, në mënyrë që të mundësojë një prezantim të duhur të pasurive në vitin 2014. Mund të konsiderohet mbështetja e duhur dhe në kohë e një Komiteti të brendshëm të Inventarizimit të Pasurive;
- Të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar çdo tremujor, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të dhëna, duke identifikuar stafin/njësine/entitetin përgjegjës, dhe duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme;
- Të monitorojë në mënyrë sistematike performancën buxhetore në baza mujore dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat për të planifikuar nivelet e ekzekutimit të buxhetit. Nëse supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final. Të sigurohet se plani i realizimit të të hyrave vetanake përbën plan realist dhe përkon me mundësitë e Komunës për mbledhjen e të hyrave. Për më shumë duhet siguar se janë ndërmarrë gjithë masat për mbledhjen e këtyre të hyrave;
- Të ndërmarrë hapa për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyrë që të sigurojë kontrole të sigurta, efeciente dhe efektive në faturim dhe të hyra. Përmirësimi i procedurave në lidhje me sisteme të tilla do ti mundësonte menaxhmentit të monitorojë dhe menaxhojë rreziqet e mëdha dhe të sigurohet që vendimet në lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë zbatuar siç duhet;

-
- Të kryejë një vlerësim të detajuar të procesit të prokurimit dhe kontrollit për të kuptuar se pse dobësitë vazhdojnë të shfaqen dhe të identifikojë veprimet që duhen zbatuar për t'i adresuar këto dobësi;
 - Të sigurojë një proces automatik dhe efektiv të regjistrimit dhe raportimit të shpalosjeve në PVF për vitin 2014, që përfshin formalisht edhe rishikimin nga menaxhmenti të draft pasqyrave, me fokus të veçantë në fushat që konsiderohen me rrezik të lartë për gabime dhe/ose fushat ku gabimet janë identifikuar në vitet e mëparshme; dhe
 - Të sigurohet pavarësia e Komitetit të Auditit si dhe të hartohen politika dhe procedura të përshtatshme që sigurojnë standard të lartë të qeverisjes, dhe të zbatohet një program i auditimit të brendshëm për vitin 2014 me rrezik të vlerësuar, i cili i ofron menaxhmentit siguri në lidhje me funksionimin efektiv, ose sistemet financiare kyçe.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Komunes të përgatisë pasqyrat financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për 'Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme' dhe kërkesave të tjera specifike. Ne jemi përgjegjës për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar shkallën deri në të cilën mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale gjatë përcaktimit të testimit të kërkuar për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e auditimit dhe fokusin e auditimit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Kryetarit ndaj të gjeturave tona mund të gjenden në Shtojcën III. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2012 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për plotësi, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do ti raportohen veçmas stafit të financave.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Konkluzioni i përgjithshëm

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh Deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ ('ZKA' ose Kryetari) dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri. Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Ne kemi shprehur një opinion të pa-modifikuar me paragraf për 'Çështje Tjetër' sepse gjashtë dosje të prokurimit me shumë totale të kontraktuar prej 336 mijë Euro dhe vlerë totale të paguar deri në fund të vitit 2012 prej 299 mijë Euro, ishin nën hetime nga zyra e prokurorit publik dhe nuk na janë dhënë gjatë auditimit të viteve 2012 dhe 2013. Gjithashtu Komuna nuk i ka adresuar plotësisht rekomandimet tona për pasuritë e paraqitura në PVF. Në PVF u identifikuan një numër gabimesh jo materiale dhe kërkesat e raportimit ishin plotësuar. Nuk ka përjashtime të mëdha të identifikuara lidhur me përmbushjen e detyrimeve për raportim të jashtëm. Megjithatë, paragrafi bazë për opinionin me rezervë dhe ai i 'Çështjes Tjetër' tregon se Deklarata së cilës i kemi referuar më lart, nuk ishte e saktë në të gjitha aspektet.

Duke ju referuar ISSAI 200, këtë vit ka patur ndryshime në terminologjinë për format e opinionit. Këtë vit shprehemi 'opinion i pa-modifikuar' në vend të 'opinionit i pa-kualifikuar' si në vitin e shkuar. Për më shumë mbi format e opinioneve referojuni shtojcës I 'Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara' në këtë raport.

2.1 Opinioni i Auditimit

Për Komunën Kaçanik

Prishtinë, 6 qershor 2014

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Komunës Kaçanik ('Komuna'), të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013, një krahasim të buxhetit me shumatat aktuale, dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe të shënimeve të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik ('SNKSP') për 'Raportimin Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme' dhe me Rregulloren MF - Nr. 03/2013 'Për Pasqyrat Financiare Vjetore të Organizatave Buxhetore'. Kjo përgjegjësi përfshin hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e një kontrolli të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe prezantimin e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në auditimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me Parimet dhe Udhëzimet Themelore të Auditimit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA). Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të arritur një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, kontrolli i brendshëm i entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare merret në konsideratë në mënyrë që të planifikojmë procedura auditimi të përshtatshme në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo për qëllimin që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së pasqyrave financiare.

Ne besojmë së evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Komunës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013 janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me SNKSP për 'Raportimin Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme' dhe me Rregulloren MF - Nr. 03/2013 'Për Pasqyrat Financiare Vjetore të Organizatave Buxhetore'.

Çështje Tjetër

Pa e kualifikuar opinionin tonë, ne tërheqim vëmendjen për sa më poshtë:

- Gjashtë dosje prokurimi me vlerë totale të paguar deri në fund të vitit 2012 prej 299 mijë Euro, janë nën hetime nga zyra e prokurorit publik dhe nuk na janë vënë në dispozicion. Ne nuk jemi në dijeni për arsyet dhe statusin e këtyre hetimeve, dhe as për rezultatin e mundshëm të tyre.
- Neni 16 përfshin informacione për pasuri jofinanciare kapitale dhe jokapitale. Për shkak të mungesës së dokumentave të pronësisë së disa pasurive, ka pasiguri lidhur me të drejtat e pronësisë së Komunës. Për më tepër, për shkak të mungesës së dokumentave për matjen e një pjese të rëndësishme të këtyre pasurive, Komuna ka tentuar të masë vetëm disa nga pasuritë kryesore me vlerën e tregut, në bazë të një vlerësimi të kryer nga një komision i krijuar brenda Komunës.
- Në Nenin 12 Komuna ka paraqitur si 'Pagesa nga palët e treta' 764 mijë EUR që përfaqësojnë investime të financuara nga Ministritë e Kosovës, dhe jo nga palët e treta. Për më tepër, nuk është kryer ende transferimi zyrtar i pronësisë për një pjesë të rëndësishme të pasurive të paraqitura si 'Pagesa nga palët e treta'.

KPMG Albania Shpk Kosovo Branch

KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch

Sulejman Vokshi, No. 14

Pristina

Kosovo

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Gjatë kryerjes së auditimit, ne kemi identifikuar rrezik në lidhje me prokurimet, me prezantimin e Nenit 16, Shpalosja e Pasurive dhe Pagesat nga Palët e treta.

Rreziku pasqyron sa vijon:

- Mungesën e disa dosjeve të prokurimit të cilat janë nën hetim nga zyra e prokurorit publik që prej vitit të shkuar dhe për të cilin nuk dihet se cili është rezultati final.
- Paqartësitë lidhur me mungesën e dokumentacionit të pronësisë dhe për matjen e një pjese të rëndësishme të pasurive.
- Shpalosja e pasurive nuk është e plotë, për arsye se jo të gjitha pronat, ndërtesat dhe pajisjet janë përfshirë në vlerësim.

Gjithashtu ne kemi identifikuar rreziqe në lidhje me çështje të tjera të pajtueshmërisë (Çështja 3 më poshtë).

Rreziku është identifikuar dhe ka ndodhur.

Rreziku i identifikuar

Qasja jonë deri tani pasqyron reagimin tonë të auditimit për periudhën deri në 31 dhjetor 2013, siç shpjegohet edhe brenda memorandumit të planifikimit të auditimit. Ne tërheqim vëmendjen për çështjet më poshtë:

Çështja 1 - Dosjet e prokurimit nën hetim

E gjetura

Gjashtë dosje të prokurimit me shumë totale të kontraktuar prej 336 mijë Euro dhe vlerë totale të paguar deri në fund të vitit 2012 prej 299 mijë Euro, ishin nën hetime nga zyra e prokurorit publik dhe nuk na janë dhënë gjatë auditimeve të viteve 2013 dhe 2012. Ne nuk jemi në dijeni për arsyet dhe statusin e atyre hetimeve, si dhe për rezultatin e mundshëm final. Gjithashtu, ne kemi identifikuar një numër mospërputhshjesh me Ligjin Nr. 04L-042 "Ligji i Prokurimit Publik në Kosovë" (i ndryshuar). Mospërputhje të tilla janë të lidhura me procedurat e kërkuara të cilat Komuna nuk i ka kryer dhe dokumentuar.

Rreziku

Në mungesë të dosjeve të prokurimit ne nuk kemi mundësi të japim një konkluzion mbi to. Si rezultat i procedurave të dobëta të prokurimit, mund të bëhen pagesa të parregullta, vonesa në ofrimin e shërbimeve, vlerë e dobët për paranë e shpenzuar, kontrata të fituara nga palë të papërshtatshme, si dhe kontratat mund të mos implementohen sipas standardeve të kërkuara.

Përgjigja e Auditimit

Ne kemi konsideruar kontrollet e brendshme të Komunës dhe proceset e lidhura me prokurimin dhe regjistrimin e aktiveve dhe shpenzimeve të tjera. Ne i kemi raportuar Komunës gjetjet tona nga kjo punë, dhe kemi rekomanduar që të ndërmerren masa për zbatimin e kërkesave të ligjit.

Çështja 2 - Neni 16, 'Shpalosja e Pasurive' dhe Pagesat nga Palë të treta

E gjetura

Diferenca mes totaleve të treguara në Nenin 16 'Shpalosja e pasurive' për vitet e mbyllura me 31 dhjetor 2013 dhe 2012, nuk barazon me shtesat në pasuri të paraqitura në Nenin 12 për 1,436 mijë EUR. Për disa pasuri ka pasiguri në lidhje me të drejtat e pronësisë midis Komunës dhe Agjencive të tjera të ndryshme të Qeverisë së Kosovës dhe mungesë të dokumentacionit të pronësisë. Gjithashtu, për pranimet nga Ministritë në vitin 2013 prej 764 mijë EUR, nuk ka dokumenta mbështetës të transferimit dhe të pronësisë. Për më tepër, si pasojë e mungesës së dokumentacionit përkatës për matjen e një pjese të konsiderueshme të këtyre aseteve, Komuna ka kërkuar të masë këto objekte me vlerën e drejtë në bazë të një vlerësimi të kryer nga një komitet i

brendshëm. Vlerësimi përfshinte vetëm ndërtesat kryesore komunale dhe jo të gjitha pronat, ndërtesat dhe pajisjet.

Rreziku

Për shkak të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, ka paqartësi lidhur me të drejtat e pronësisë së pasurive në mes të Komunës dhe të Agjencive të tjera të ndryshme të Qeverisë së Kosovës. Si rezultat Komuna, mund të përballet me vështirësi në shfrytëzimin e këtyre pasurive në të ardhmen. Gjithashtu, Shpалosja e pasurive nuk është e plotë, për arsye se jo të gjitha pronat, ndërtesat dhe pajisjet janë përfshirë në vlerësim. Këto mungesa mund të rezultojnë në vlera materiale të pasurive që nuk përfshihen në PVF-të e Komunës ose përfshihen me vlera jo reale, dhe në paaftësi të manaxhmentit për të kontrolluar dhe shfrytëzuar pasuritë në dobi të Komunës.

Përgjigja e Auditimit

Ne kemi konsideruar kontrollet e brendshme të Komunës ose proceset tjera që lidhen me regjistrimin e pasurive dhe pagesave nga palët e treta në PVF. Ne i kemi rekomanduar Komunës veprime shtesë që kërkohen për të siguruar një proces efektiv të regjistrimit të pasurive dhe raportimit të tyre në PVF-të e 2013.

Gjithashtu, ne kemi audituar mostrën e shpenzimeve të cilat përbëjnë shtesa në pasuri për periudhën, për të përcaktuar nëse është aplikuar qasja e kapitalizimit të pritshëm, e klasifikimit të duhur dhe e përfshirjes në shpалosjen e pasurive dhe kemi informuar menaxhmentin mbi rezultatet e kësaj pune.

Çështja 3 - Çështje të tjera të pajtueshmërisë

E gjetura

Çështjet e tjera të pajtueshmërisë janë të përmbledhura më poshtë:

- Burimi kryesor e i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance, i cili nuk përdoret për të regjistruar të hyrat nga gjobat, pagesat nga palët e treta dhe faturat e papaguara.
- Komuna nuk ka implementuar një sistem faturimi automatik dhe gjithëpërfshirës.
- Komuna nuk ka ndonjë procedurë formale që do të siguronte informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për çështjet ligjore.
- Komuna nuk ka dorëzuar pasqyra financiare në gjuhën serbe.

Rreziku

- Free Balance nuk siguron plotësi të informacionit të kërkuar për qëllime të raportimit financiar dhe nuk mund të përdoret i vetëm për të gjeneruar pasqyra të plota financiare.
- Ekziston një pasiguri lidhur me plotësinë e të arkëtueshmeve dhe të hyrave që Komuna mund të fitojë, dhe kjo dëmton aftësinë për të përgatitur një buxhet të besueshëm dhe të saktë, për të raportuar një raport të saktë arkëtueshmërie, dhe për të monitoruar arkëtimet e të hyrave vetanake në kohë.
- Edhe pse Komuna mund të jetë e përfshirë në disa çështje të vogla ligjore, mungesa e procedurave formale të identifikimit të tyre mund të dobësojë aftësinë për të parashikuar dhe manaxhuar flukset dalëse monetare të ardhshme të kërkuara, si edhe për të raportuar dhe regjistruar provizionet dhe detyrimet kontigjente lidhur me këto çështje.
- Mungesa e pasqyrave në gjuhën serbe kufizon përdorimin e lexuesve dhe kjo praktikë nuk është në pajtim me legjislacionin.

Përgjigja e Auditimit

Ne kemi konsideruar kontrollet e brendshme të Komunës dhe proceset që lidhen me regjistrimin dhe paraqitjen në PF për ato shpалosje të cilat nuk raportohen sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme dhe nuk regjistrohen në Free Balance. Këto shpалosje përfshijnë të hyrat nga gjobat, pagesat nga palët e treta, të arkëtueshmet dhe detyrimet kontigjente.

Ne i kemi rekomanduar Komunës veprime shtesë që kërkohen për të siguruar një proces automatik dhe efektiv të regjistrimit dhe raportimit të shpalosjeve në PVF-të e 2013.

Ne i kemi rekomanduar Komunës zbatimin e një procesi formal që do të siguronte informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontigjente.

Ne i kemi rekomanduar Komunës përgatitjen e PVF në gjuhën serbe.

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

Vetëm pjesërisht pasqyrat financiare kanë përmbushur kërkesat e SNKSP 'Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme' dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me RrF nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- Afatet e dorëzimit të raportimeve në MF;
- Kërkesat për nënshkrim të PVF nga ZKA ('Kryetari') dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- Kërkesat për të përgatitur PVF në kopje elektronike dhe fizike; dhe
- Dorëzimi i raportimeve tremujore tek Asambleja Komunale dhe MF.

Siç kemi raportuar në Memorandumin e Auditimit në dhjetor 2013, pasqyrat financiare nëntëmujore nuk janë nënshkruar dhe dorëzuar në Ministrinë e Financës ("MF") brenda afatit të kërkuar më 31 tetor 2013. Ne i kemi pranuar ato pasqyra në nëntor 2013.

Në draft pasqyrat financiare vjetore u nevojiti që të bëheshin disa korrigjime dhe ne kemi dhënë edhe disa sugjerime të tjera për të përmirësuar shpalosjet dhe për të siguruar plotësinë e shpalosjeve. Gjetjet tona janë paraqitur më poshtë.

E gjetura

Burimi kryesor e i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance, i cili nuk përdoret për të regjistruar dhe raportuar gjithë shpalosjet të cilat nuk raportohen sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme. Këto shpalosje përfshijnë të hyrat nga gjobat, pagesat nga palët e treta, të arkëtueshmet dhe detyrimet kontigjente.

Mospërputhjet e mëposhtme u identifikuan në pasqyrat financiare:

- Numri aktual i punëtorëve në fillim të vitit 2013 sipas Nenit 22 tregon katër punëtorë më pak se listat e pagave dhe numri total i punëtorëve e tejkalon numrin e punëtorëve sipas ligjit të buxhetit për shtatë punëtorë në fillim të vitit dhe për një punëtor në fund të vitit.
- Në Shënime 23-25 nuk janë dhënë detaje të mjaftueshme për arsyet e ekzekutimit të ulët të buxhetit, megjithëse Komuna ka dhënë sqarime për burimet e financimit dhe destinimin e fondeve përkatëse.
- Janë përdorur klasifikime të ndryshme për shpenzimet për mallra dhe shërbime dhe për shpenzimet komunale sipas buxhetit fillestar në Nenin 13 dhe në Nenin 18, Shënimi 36. Kishte një diferencë prej 12 mijë EUR në klasifikim, ndërsa në total buxheti barazonte. Gjithashtu pagesat nga palë të treta në vitin 2012 ishin përfshirë të gjitha në Shënimin 12, ndërsa në Nenin 12 janë prezantuar në dy kategori të ndryshme.

Pasqyrat financiare nuk ishin përgatitur në gjuhën Serbe.

Ka diferenca të vogla dhe rumbullakimi në disa shënime dhe disa formatime që mund të përmirësohen më tej për të siguruar një prezantim të mirë të pasqyrave.

Rreziku

Free Balance nuk siguron plotësi të informacionit të kërkuar për qëllime të raportimit financiar dhe nuk mund të përdoret i vetëm për të gjeneruar pasqyra të plota financiare.

Shpalosjet e paqarta kufizojnë përdorimin e lexuesve dhe mund të rezultojnë në keqinterpretime.

Mungesa e pasqyrave në gjuhën serbe kufizon përdorimin e lexuesve dhe kjo praktikë nuk është në pajtim me legjislacionin e me rregullën financiare 03/2013.

Rekomandime

Ne rekomandojmë që Kryetari i Komunës të sigurohet se:

-
- Përgatitja e pasqyrave financiare do të përfshijë procedura dhe mjete të projektuara për t'u siguruar që informatat e kërkuara janë të regjistruara, të procesuara, të përmbledhura dhe të raportuara në mënyrë të përshtatshme në pasqyra financiare.
 - Informacioni mbi pagesat nga palët e treta, shumat e të arkëtueshmeve dhe detyrimeve kontigjente duhet të përditësohet rregullisht dhe të rishikohet për të siguruar saktësinë dhe plotësinë e shpalosjeve të tilla në pasqyrat financiare.
 - Numri i punëtorëve monitorohet vazhdimisht dhe raportohet rregullisht për të siguruar pajtueshmëri me kufijtë e buxhetit dhe me kërkesat për raportim.
 - Komuna do të përgatisë pasqyrat financiare në gjuhën Serbe.

2.4 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

Përshkrim

Përveç hartimit të PVF-ve, nga Komuna kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm, duke përfshirë sa vijon:

- Kërkesa Buxhetore
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntëmujore në kohë;
- Raportet operative (performancës), nëse ka;
- Draft plani dhe i prokurimit në kohë; dhe
- Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, përfshirë në pasqyrat vjetore financiare të Komunës.

Nuk ka përjashtime të mëdha të identifikuar lidhur me përmbushjen e detyrimeve aktuale të raportimit të jashtëm, si dhe procesit buxhetor.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Që prej pranimit të rekomandimeve tona për vitin 2012 në korrik 2013, vetëm disa veprime janë ndërmarrë për t'i adresuar shqetësimet e ngritura. Është e rëndësishme që të ndërmerren veprime proaktive nga Komuna për të siguruar përmirësimin e fushave kryesore të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2012 të Komunës ka rezultuar në shtatë rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohen të gjitha rekomandimet. Megjithatë periodha e specifikuar nuk është respektuar plotësisht.

Rekomandimet janë adresuar pjesërisht.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2013, një rekomandim është adresuar pjesërisht, dhe gjashtë nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të Rekomandimeve dhe mënyrës si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja – Adresimi i Rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura

Vetëm një pjesë e Rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar dhe Komuna nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të Rekomandimeve.

Rreziku

Dobësitë e vazhdueshme të përmendura më lart kanë rezultuar në:

- Mosrealizim të planit buxhetor;
- Jo-efikasitet organizativ dhe vlerë e mundshme e dobët për para në praktikën e prokurimit;
- Vonesa në përmirësimin e kontrolleve që ndërlidhen me të hyrat; dhe
- Shpallje jo të plota ose të pasakta të pasurisë në pasqyrat financiare të Komunës.

Rekomandime

Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të dhëna, duke identifikuar stafin përgjegjës dhe duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv dhe rezultateve nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky nivel, për shembull, mund të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrollet operative të nivelit më ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave e llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, duke përfshirë rolin e ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm dhe Komitetet e Auditimit.

Të hyrat aktuale vetanake janë realizuar në nivelin 67% të buxhetit për vitin 2013, dhe janë ulur me 5% krahasuar me të hyrat për vitin 2012. Ekzekutimi i ulët i Buxhetit është një nga fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime.

4.2 Qeverisja e mirë

Përshkrim

Nuk ka përjashtime të mëdha të identifikuara.

Rekomandime

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Në vitin 2013, ekzekutimi i buxhetit për shpenzime është në nivelin 94% të buxhetit total. Ky ekzekutim përfaqëson rritje me 2% prej vitit 2012. Ekzekutimi i ulët krahasuar me buxhetin final lidhet kryesisht me investimet kapitale, por edhe me kategoritë e tjera të shpenzimeve.

Të hyrat aktuale vetanake janë realizuar në nivelin 67% të buxhetit për vitin 2013, dhe janë ulur me 5% krahasuar me të hyrat për vitin 2012.

Ne kemi paraqitur në tabelën e mëposhtme buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar të Komunës, burimet e të hyrave dhe shpenzimin e fondeve sipas kategorive ekonomike:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore- realizimi ndaj buxhetit (në €'000)

Përshkrimi	Buxheti Fillestar 2013	Buxheti Final ¹ Vjetor 2013	Realizimi Vjetor 2013	Realizimi Vjetor 2012	Realizimi Vjetor 2011
Granti Qeveritar	5,011	5,011	4,992	4,976	4,936
Të hyrat vetanake të bartura nga viti paraparak ²	-	174	132	97	203
Të hyrat vetanake ³	600	600	325	275	389
Donacionet e brendshme	-	1	-	-	-
Donacionet e jashtme	-	110	108	89	65
Burimet e fondeve	5,611	5,896	5,557	5,437	5,593

Tabela 2: Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike-realizimi ndaj buxhetit (në €'000)

Përshkrimi	Buxheti Fillestar 2013	Buxheti Final Vjetor 2013	Realizimi Vjetor 2013	Realizimi Vjetor 2012	Realizimi Vjetor 2011
Pagat dhe Mëditjet	3,744	3,745	3,732	3,728	3,556
Mallrat dhe Shërbimet	523	571	530	511	433
Shpenzimet Komunale	121	121	113	164	87
Subvencionet dhe Transferet	130	137	129	39	73
Investimet Kapitale	1,093	1,322	1,053	995	1,444
Shpenzimet totale	5,611	5,896	5,557	5,437	5,593

Tabela 3. Të hyrat vetanake- realizimi ndaj buxhetit (në €'000)

Përshkrimi	Buxheti Fillestar 2013	Buxheti Final Vjetor 2013	Realizimi Vjetor 2013	Realizimi Vjetor 2012	Realizimi Vjetor 2011
Të hyrat vetanake ⁴	600	600	404	426	510

- Ekzekutimi i buxhetit në investimet kapitale më 31 dhjetor 2013 ishte 80% në krahasim me buxhetin final për vitin 2013. Në vitin 2012, ekzekutimi i buxhetit për investimet kapitale ka mbetur në nivelin vjetor prej 70%. Ekzekutime të ulta vihen re në kategori të tjera të shpenzimeve të periudhës. Shfrytëzimet e fondeve për investimet kapitale në vitin 2013 u rritën me 6% të shumave të raportuara në vitin 2012.
- Të hyrat aktuale vetanake janë realizuar në nivelin 67% të buxhetit për vitin 2013, dhe janë ulur me 5% krahasuar me të hyrat për vitin 2012. Realizimi i të hyrave vetanake vjetore në vitin 2012 ishte 72% krahasuar me buxhetin e vitit.
- Të arkëtueshmet sipas sistemit qendror për tatimin në pronë nuk pajtohen me të arkëtueshmet për tatimet e tilla të shpalosura në Shënimin 34 të pasqyrave financiare për 131 mijë Euro.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraparak të bartura në vitin aktual.

³ Një pjesë të arkëtimeve të planifikuara dhe të mbledhura për Buxhetin e Kosovës në vitin e tanishëm i cili është përdorur nga njësia ekonomike për financimin buxhetin e vet.

⁴ Të hyrat vetanake të mbledhura gjatë vitit 2013.

Mbledhja e të hyrave vetanake nga tatimi në pronë më 31 dhjetor 2013 sipas Free Balance përbën vetëm 56% të faturimit total të periudhës. Nuk kemi informacion për të treguar nëse arkëtimet gjatë vitit 2013 lidhen me fatura të vitit 2013, apo të viteve të mëparshme.

Për shkak të mungesës së sistemeve të faturimit për llojet e tjera të të hyrave, ne nuk mund të llogarisim një raport arkëtueshmërie për ato të hyra.

Çështja - Ekzekutimi i buxhetit - Prioriteti i Lartë

E gjetura

Ekzekutimi i buxhetit nuk ishte në nivelin e pritur. Ekzekutimi i ulët krahasuar me buxhetin final lidhet kryesisht me investimet kapitale dhe gjithashtu me kategoritë e tjera të shpenzimeve. Të hyrat aktuale vetanake janë realizuar në nivelin 67% të buxhetit për vitin 2013, dhe janë ulur me 5% krahasuar me të hyrat për vitin 2012.

Rreziku

Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimi/ekzekutimi i ulët i buxhetit mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.

Rekomandime

Kryetari duhet të monitorojë në mënyrë sistematike performancën buxhetore në baza mujore dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat për të planifikuar nivelet e ekzekutimit të buxhetit. Nëse supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.

Kryetari duhet të sigurohet se plani i realizimit të të hyrave vetanake përbën plan realist dhe përkon me mundësitë e Komunës për mbledhjen e të hyrave. Për më shumë duhet siguruar se janë ndërmarë gjithë masat për mbledhjen e këtyre të hyrave.

4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Përshkrimi

Të hyrat vetanake të gjeneruara nga Komuna në vitin 2013 ishin në total 404 mijë EUR. Ekziston nevoja për përmirësim në disa procese dhe kontrole që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe me raportimin e të hyrave, me qëllim rritjen e mbledhjes së të hyrave dhe sigurimin e saktësisë dhe plotësisë së raportimeve për qëllime manaxheriale dhe për qëllime të përgatitjes së pasqyrave financiare.

Çështja - Kontrolli mbi të hyrat - Prioriteti i lartë

E gjetura

- *Sistemi i faturimit.* Një sistem automatik i faturimit ekziston vetëm për të hyrat nga tatimi në pronë. Komuna nuk mban regjistra të faturimit për llojet e tjera të të ardhurave. Në vend të kësaj, janë regjistruar vetëm arkëtimet me para të gatshme nga të hyrat e tilla.
 - *Mbledhja dhe barazimi i të hyrave:* Përveç tatimit mbi pronën, leje biznesi dhe taksa në pronat me qera, Komuna nuk mban regjistra të ndarë ose ndonjë listë të të gjithë debitorëve sipas llojeve të ndryshme të taksave. Komuna nuk ka bërë ndonjë barazim formal të të hyrave të mbledhura me departamentin e kontabilitetit përgjatë vitit 2013.
 - *Anketimi dhe verifikimi i pronave.* Nuk është kryer anketimi i gjithë pronave të reja dhe as verifikimi i 1/3 së pronave ekzistuese të tatueshme siç kërkohet të verifikohet çdo vit konform Ligjit Nr. 03/L-204, UA Nr. 03/2011 për tatimin në pronën e paluajtshme.
 - *Klasifikimi i të hyrave:* Komuna ka përdorur fletëpagesa të destinuara për 'Tatimin në pronë' për pagesa të kryera për 'Regjistrimin e veturave' në vlerën prej 20 EUR. Si pasojë, kishte diferenca mes këtyre dy kategorive sipas listave të pagesave dhe sipas regjistrimeve në free balance.
-

Rreziku

- Ekziston një pasiguri lidhur me plotësinë e të hyrave që Komuna mund të fitojë dhe të arkëtueshmeve lidhur me to, dhe si pasojë rritet rreziku i gabimeve në pasqyrat financiare dhe dobësohet aftësia e Menaxhmentit për të kontrolluar, identifikuar dhe zgjidhur këto gabime në kohën e duhur.
- Pa të dhëna të detajuara, të sakta dhe të mjaftueshme të debitorëve, Komuna nuk është në gjendje të përgatisë një buxhet të saktë dhe të besueshëm, të raportojë një raport të saktë arkëtueshmërie, dhe të monitorojë arkëtimet e të hyrave vetanake në kohë.
- Mungesa e anketimit të pronave të reja dhe verifikimit të 1/3 të pronave mund të ndikojë që Komuna mos të ketë të dhëna të sakta e të plota të pronës së tatueshme aktuale, dhe rrjedhimisht ndikon që të hyrat e vlerësuara për tatimin në pronë të ulen.
- Përdorimi i fletë pagesave jo adekuate ndikon në kategorizim të gabuar të të hyrave.

Rekomandime

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapat për të përmirësuar Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyrë që të sigurojë kontrolle të sigurta, efçiente dhe efektive në faturim dhe të hyra të mbledhura. Përmirësimi i procedurave në lidhje me sisteme të tilla do ti mundësonte menaxhmentit të monitorojë dhe menaxhojë rreziqet e mëdha dhe të sigurohet që vendimet në lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë bartur siç duhet. Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës të konsiderojë pikat si në vijim:

- Implementimin e një sistemi faturimi që përfshin detaje të përditësuara për pagesit, adresën e tyre të tanishme, historinë dhe normën e mbledhjes së të hyrave nga këta pages. Qasja në informacione të tilla duhet të jetë e limituar vetëm për një numër personash dhe me autorizimin e menaxhimit.
- Të vendosë dhe të kontrollojë në mënyrë qendrore tarifatat dhe normat e taksave të aprovuara në sistem, që të llogarisë dhe gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet të autorizohet dhe të rishikohet.
- Të ekzistojë lidhje në mënyrë automatike midis sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyrë që të dhënat në librin kryesor të procesohen në mënyrë automatike.
- Të lidhen automatikisht zyra e faturimit me operacionet dhe të bëhen barazime të rregullta ndërmjet tyre, për rastet kur faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyra operacionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ekzekutohet një numër i madh transaksionesh.
- Të bëhet anketimi i të gjitha pronave të reja dhe rianketimi i atyre ekzistuese në mënyrë që të taten drejt të gjitha pronat e Komunës.
- Të përdoren kodet dhe fletëpagesat e duhura për regjistrimin e të hyrave vetanake në kategorinë e duhur, dhe zbatimi i kontrolleve të tilla si rishikimi i rregullt i klasifikimit, në mënyrë që të sigurohet një prezantim i saktë i të ardhurave të tilla në pasqyrat financiare.

4.5 Shpenzimet

Përshkrimi

Nevojitet zhvillim i mëtejshëm në fushën e kontrolleve dhe raportimit të shpenzimeve. Si rezultat i mangësive dhe pasigurive lidhur me procedurat e prokurimit, kjo fushë paraqet një rrezik domethënës ashtu siç përmendet edhe në pikën 2 më lart.

4.5.1 Prokurimi

Përshkrimi

Janë disa aspekte të procesit të prokurimit mbi të cilat kontrollet nuk janë aplikuar në mënyrë efektive e nuk është siguruar mbajtja e të gjitha dokumenteve të kërkuara në dosje. Si rezultat, kjo fushë paraqet një rrezik domethënës ashtu siç përmendet edhe në pikën 2 më lart.

Çështja –Procedura të dobëta të prokurimeve dhe prokurime nën hetim- Prioritet i Lartë

E gjetura

- Gjashtë dosje të prokurimit ku përfshihen dosjet me nr. KA652/12/002/136, KA652/12/27/521, KA652/12/011/136, KA652/12/021/236, KA652/11/32/521 dhe KA652/11/27/521 me shumë totale të kontraktuar prej 336 mijë EUR dhe vlerë totale të paguar deri në fund të vitit 2012 prej 299 mijë EUR, janë nën hetime nga zyra e prokurorit publik dhe nuk na janë dhënë gjatë auditimeve për vitet 2012 dhe 2013. Ne nuk jemi në dijeni të arsyeve dhe statusit të hetimeve dhe as për rezultatin e mundshëm final. Nuk ka pasur komunikime zyrtare mes Komunës dhe organeve të hetuesisë në lidhje me këto raste gjatë vitit 2013.
- Prokurimi Nr. KA652/13/05/136: njoftimi për kontratë gabimisht tregon se procedura është ‘e hapur’, ndërsa sipas kodit të prokurimit dhe dosjes së tenderit procedura është ‘Kuotim i çmimit i hapur’. Edhe pse sigurimi i tenderit është kërkuar në njoftim të kontratës, ne nuk na është ofruar sigurim i tenderit për fituesin.
- Prokurimi Nr. KA652/12/44/221: një anëtar nga komisioni i vlerësimit nuk e ka nënshkruar raportin e vlerësimit.
- Në prokurimet Nr. KA652/13/31/521, KA652/13/63/521 dhe KA652/13/75/136 kishte vonesat në kryerjen e punëve sipas planit dinamik. Komuna nuk ka zbatuar ndëshkime për këto vonesa, siç parashihej me kontratë.

Rreziku

Si rezultat i procedurave të dobëta të prokurimit, mund të bëhen pagesa të parregullta, vonesa në ofrimin e shërbimeve, vlerë e dobët për parane e shpenzuar, kontrata të fituara nga palë të papërshtatshme, si dhe kontratat mund të mos implementohen sipas standardeve të kërkuara.

Rekomandime

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se:

- Komuna do të ndërmarrë hapa të mëtjeshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat, dhe të sigurojë që i gjithë dokumentacioni i kërkuar është marrë dhe paraqitur në mënyrë rigoroze në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe kerkesat e rregulloreve lokale.
- Do të bëhet një rishikim i të gjeturave të auditimit në të cilat proceset nuk janë aplikuar në mënyrë efektive, si dhe ta përcaktojë se pse kanë ndodhur dështimet në to. Veprimet/proceset e duhura duhet të implementohen për të siguruar se dështimet e tilla nuk do të ndodhin në të ardhmen.

4.5.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrim

Janë disa projekte të bashkëfinancuar për të cilët mungojnë dokumentat mbështetës të mjaftueshëm.

Çështja – Mungesa e dokumentacionit mbështetës për disa projekte-Prioritet i Lartë

E gjetura

Çështjet e mëposhtme janë vënë re sa i përket projektit 'Ndërtimi i qendrës për komunitete', i bashkëfinancuar nga Komuna, 'Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF)' dhe 'Komisioni i Projektit Kacaniku i Vjetër (CP)':

- CDF ka organizuar procedurat e prokurimit dhe Komuna nuk ka dëshmi të procedurave të tilla për të mbështetur pagesën;
- Pagesa është bazuar në kërkesën e CDF dhe faturën e CDF pa dokumente të tjera mbështetëse;

Gjithashtu, në një projekt tjetër të përbashkët Caritas Luxemburg ka organizuar procedurat e prokurimit dhe Komuna nuk ka dëshmi të procedurave të tilla për të mbështetur pagesën. Pagesa është bazuar në marrëveshjen me donatorin pa dokumente të tjera mbështetëse. Komuna ka marrë pjesë me 83 mijë EUR në këtë projekt dhe gjatë vitit 2013 ka paguar një vlerë prej rreth 40 mijë EUR.

Rreziku

Si rezultat i mungesave të dokumentave të prokurimit, mund të bëhen pagesa të parregullta, vlerë e dobët për paranë e shpenzuar, si dhe kontratat mund të mos implementohen sipas standardeve të kërkuara.

Rekomandime

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa të mëtijshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat, dhe të sigurojë që i gjithë dokumentacioni i kërkuar është marrë dhe paraqitur në mënyrë rigoroze në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale.

4.5.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Ka vonesa dhe mungesa në vendime, raportim dhe mbajtje të dosjeve të personelit.

Çështja – Mungesa e kontrollit mbi pagat dhe dosjet e personelit – Prioritet i mesëm

E gjetura

- CPO të pagave për qershorin 2013 nuk janë nëshkruar nga zyrtari administrativ në një rast dhe nga zyrtari aprovues në 6 raste.
- Për punëtorin me Nr. EM00052591 sipas akt vendimit rritja e koeficientit të pagës do të bëhej që nga 21 Marsi 2013, ndërsa në listën e pagave nga Ministria e Shërbimeve Publike rritja e koeficientit të pagës është reflektuar që nga muaji Maj 2013.
- Për punëtorët me Nr. EM00099171 dhe EM00057871 nuk ishte në dosje shpallja në gazetë për vendin e punës dhe dokumentimi i intervistimit të kandidatëve.
- Për punëtorin me Nr. EM00130694 nuk ishte në dosje dokumentimi i vlerësimit të performancës.
- Për punëtorin me Nr. EM00019900 nuk ishte në dosje kodi i etikës i nënshkruar.

Rreziku

Mungesa e kontrolleve mbi plotësinë e të dhënave, dokumentave dhe mbi pagat e personelit mund të rrisë rrezikun e gabimeve të paidentifikuara dhe keqpërdorim të buxhetit për paga.

Rekomandime

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna raporton dhe arkivon të dhëna të plota lidhur me pagat dhe mëditjet dhe zbaton kërkesat për miratim të pagesave dhe dosjet e personelit.

4.5.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Nuk ka përjashtime të mëdha të identifikuara.

Rekomandime

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.6 Pasuritë dhe obligimet

4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

- Ekzistojnë disa pasiguri dhe mangësi në lidhje me pasuritë e Komunës dhe janë adresuar vetëm pjesërisht rekomandimet tona lidhur me Nenin 16 Shpalosja e pasurive gjatë viteve të fundit. Gjetjet e detajuara më poshtë, të marra së bashku japin efekte që rezultojnë në rrezik domethënës, ashtu siç përmendet edhe në Pjesën 2 të këtij dokumenti.
- Si pasojë e mungesës së koordinimit dhe barazimit të shpeshtë dhe të rregullt të dhënave mes palëve të treta dhe Komunës të dhënat e prezantuara nga Komuna mund të jenë të mangëta dhe me gabime.

Çështja 1 - Pasiguri në lidhje me Nenin 16, Shpalosja e pasurive - Prioritet i lartë

E gjetura

- Për disa pasuri ekzistojnë paqartësi lidhur me të drejtat e pronësisë së Komunës apo të Agjencive të tjera Qeveritare të Kosovës dhe ka mungesë dokumentacioni për pronësinë e tyre.
- Si pasojë e mungesës së dokumentacionit përkatës për matjen e një pjese të konsiderueshme të asetëve, Komuna ka kërkuar të masë këto objekte me vlerën e drejtë në bazë të një vlerësimi të kryer nga një komitet i brendshëm. Vetëm ndërtesat kryesore komunale që nuk ishin raportuar në periudhat e mëparshme u identifikuan dhe u regjistruan. Vlerësimi ishte më i ulët se vlera e shpalosur në Nenin 16 për 918 mijë EUR, dhe kjo diferencë nuk ishte sqaruar apo barazuar. Pritet që në periudhat e ardhshme të regjistrohen edhe pasuri tjera që nuk janë ende në regjistrat aktualë të pasurive të Komunës.
- Komuna nuk ka një zyrtar të pasurisë dhe nuk ka të regjistruar asnjë pasuri në free balance gjatë vitit 2013. Komuna nuk ka përgatitur një listë të detajuar të lëvizjeve në vitet 2013 dhe 2012 për të mundësuar pajtimin e informatave të prezantuara në pasqyrat financiare dhe nuk ka mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës me informacione të tilla si data e blerjes dhe asgjësimit të aktivitetit, dhe zhvlerësimi për vitin. Si mungesë e këtij verifikimi, diferenca mes bilanceve të paraqitura në Nenin 16 për vitet 2012 dhe 2013, nuk barazon me shtesat totale për vitin 2013 të paraqitura në Nenin 12 me një diferencë të pasqaruar prej 1,436 mijë EUR.
- Komuna nuk ka pranuar informacion të rregullt zyrtar nga Ministrinë gjatë vitit 2013 për pasuritë që mund të kenë realizuar këto Ministri në këtë Komunë gjatë viteve të mëparshme dhe në vitin 2013. Si pasojë Komuna mund të duhet të bëjë korrigjime të rëndësishme në të dhënat ekzistuese lidhur me pasuritë e financuara nga palë të treta në pasqyrat financiare dhe në regjistrin e mjeteve fikse në të ardhmen.

Rreziku

- Edhe pse Komuna ka kryer punë për të zgjidhur çështjet e lidhura me regjistrimet jo të sakta e të plota për pasuritë dhe për pranimet kapitale gjatë viteve të mëparshme, ato çështje janë rrjedhojë e mungesës së një procesi që do të siguronte plotësi të të dhënave nëpërmjet një komunikimi të rregullt dhe barazimeve të informatave nga burime të ndryshme, si edhe nga palët e përfshira në financimin e pasurive të Komunës. Ky proces ende nuk është siguruar.
- Për shkak të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, ka paqartësi lidhur me të drejtat e pronësisë së pasurive në mes të Komunës dhe të Agjencive të tjera të ndryshme të Qeverisë së Kosovës. Si rezultat, Komuna mund të përballlet me vështirësi në shfrytëzimin e këtyre pasurive në të ardhmen.
- Shpalosja e pasurive nuk është e plotë, për arsye se jo të gjitha pronat, ndërtesat dhe pajisjet janë përfshirë në vlerësim. Këto mungesa mund të rezultojnë në vlera materiale të pasurive, që nuk përfshihen në PVF-të e Komunës ose përfshihen me vlera jo reale, dhe në paaftësi të manaxhmentit për të kontrolluar dhe shfrytëzuar pasuritë në dobi të Komunës.

Rekomandime

Ne rekomandojmë që Kryetari të përfshijë burime shtesë në regjistrimin, kontrollimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës dhe të sigurohet se në mënyrë të vazhdueshme Komuna regjistron dhe prezanton në pasqyrat e saj financiare të gjitha pasuritë, si edhe barazon informatat nga të gjitha burimet e përfshira në financimin e pasurive.

Çështja 2 - Pagesat nga palët e treta- Prioritet i lartë

E gjetura

Free Balance nuk përdoret për të regjistruar pagesat nga palët e treta. Si rrjedhojë sistemet qendrore të informacionit në përdorim të Komunës, nuk sigurojnë të dhëna të plota financiare për këto pagesa. Në Nenin 12 Komuna ka shpalosur 764 mijë EUR pranime nga Ministritë për investime kapitale. Komuna nuk posedon dokumente transferimi e pronësie për këto investime kapitale.

Rreziku

Si pasojë e mungesës së koordinimit dhe barazimit të të dhënave mes palëve të treta dhe Komunës, të dhënat e prezantuara nga Komuna mund të jenë të mangëta dhe me gabime.

Rekomandime

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna po bën përpjekjet maksimale për sigurimin e të dhënave nga palët e treta, me theks të veçantë tek ato palë që dihet se kanë kryer investime të rëndësishme në Komunë. Të dhënat e siguruara duhet të paraqiten drejt në regjistrin e pasurive të Komunës. Praktika e mirë do kërkonte që në baza vjetore të bëhet barazimi i të dhënave mes palëve të treta dhe Komunës për investimet në Komunë për vitin përkatës.

4.6.2 Trajtimi i parasë së gatshme (dhe ekuivalentëve të parasë së gatshme, nëse e aplikueshme)

Përshkrim

Nuk ka përfshirje të mëdha të identifikuar

Rekomandime

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë

4.6.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrim

Komuna nuk ka zbatuar një proces të mjaftueshëm për planifikimin, identifikimin, raportimin dhe arkëtimin e faturave të lëshuara për taksat e saj.

Çështja - Mungesa e kontrolleve dhe vlerësimeve mbi arkëtimin e të hyrave - Prioritet i lartë

E gjetura

Shumica e llogarive të arkëtueshme të paraqitura në pasqyrat financiare lidhen me vitet e mëparshme. Komuna nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për të mbledhur këto shuma dhe nuk ka kryer analiza për vjetërsinë e tyre.

Rreziku

Mungesa e kontrolleve të mjaftueshme mbi arkëtimin e të hyrave dhe e informacionit për vjetërsinë e shumave të arkëtueshme, ndikon negativisht mbi mbledhjen e të hyrave dhe si rezultat edhe mbi fondet që Komuna gjeneron për të mbuluar shpenzimet dhe investimet e saj. Këto mungesa pengojnë identifikimin e problemeve, monitorimin dhe përqendrimin e burimeve të duhura në arkëtimin e të hyrave, dhe prezantimin në pasqyrat financiare të shumave të sakta dhe të plota që pritet të mblidhen.

Rekomandime

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna ndërmerr hapa të mëtejshëm për përmirësimin e kontrolleve dhe se vepron në përputhje me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve vendore lidhur me arkëtimet e të hyrave.

4.7 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Nuk ka përjashtime të mëdha të identifikuara.

Rekomandime

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Komuna nuk ka krijuar struktura të auditimit të brendshëm që do të siguronin pavarësi të mjaftueshme të auditimit të brendshëm, sipas modeleve dhe praktikave më të mira në këtë fushë.

Çështja - Mungesa e pavarësisë së Komitetit të Auditimit- Prioritet i lartë

E gjetura

Megjithëse Komuna ka krijuar një Komitet Auditimi, ky i fundit ka mbajtur vetëm 2 mbledhje gjatë vitit dhe jo 3 siç kërkohet. Anëtarët e Komitetit të Auditimit janë punonjës të Komunës dhe si rezultat nuk e kanë të mundur të kryejnë përgjegjësitë e tyre me pavarësinë e duhur. Me datë 18 Nëntor 2013, Kryetari ka marrë vendim për të ndërruar kryetarin dhe anëtarët e Komitetit të Auditimit.

Rreziku

Si rezultat i mosfunksionimit të plotë të Komitetit të Auditimit dhe mungesës së pavarësisë së tij, zvogëlohet siguria që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e sistemeve financiare dhe kontroleve. Kjo mund të rezultojë me dobësi të pidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave joefektive që rezultojnë me humbje financiare për Komunën.

Rekomandime

Ne rekomandojmë që Kryetari të bëjë një Plan Veprimi që duhet zbatuar për të siguruar se puna e auditimit të brendshëm është bërë dhe raportuar mbi një bazë kohore dhe për të adresuar rekomandimet e rezultuara, detajon oficerët përgjegjës dhe afatin kohor për zbatim.

Kryetari duhet të punojë me Auditimin e Brendshëm për të siguruar aktivitete të mjaftueshme mbi sistemet financiare të vitit, para se të nxirret drafti i PVF-ve. Përmbushja e aktiviteteve të planifikuara të auditimit duhet të monitorohet çdo dy muaj dhe të ndërmerren veprime proaktive, në mënyrë që devijimet të adresohen në kohën e duhur.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornizë për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk përhapen në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë materiale por nuk përhapen.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe përhapen në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë edhe materiale edhe të përhapen. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705¹⁹ jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori konsideron të nevojshëm komunikimin e një çështje, të ndryshme nga ato që janë përfshirë apo shpalosur në pasqyrat financiare, e cila në gjykimin e auditorit është e rëndësishme për të kuptuar auditimin, përgjegjësitë e auditorit, ose raportin e auditorit dhe nëse nuk ndalohet nga ligji apo rregulloret, kjo duhet bërë me një paragraf të quajtur "Çështje Tjetër" ose me një emër tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet vendosur menjëherë pas opinionit dhe paragrafit të theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të zgjidhura	Rekomandimet pjesërisht të zgjidhura	Rekomandimet e pa zgjidhura
2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF	Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se informacioni mbi pagesat nga palët e treta, shumat e të arkëtueshmeve dhe faturave të papaguara do të përditësohet rregullisht dhe të rishikohen për të siguruar saktësinë dhe plotësinë e shpalosjeve të tilla në pasqyrat financiare.			Për t'u zgjidhur
4.4 Të hyrat vetanake	Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyrë që të sigurojë kontrollë të sigurt, efeciente dhe efektive në faturim dhe të hyra.			Për t'u zgjidhur
4.5.1 Prokurimi	Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurojë një proces, i cili siguron që të arkëtueshmet janë të regjistruara mbi lëshimin e çdo fature dhe se shumat e mbetura janë përcjellë rregullisht.			Për t'u zgjidhur
4.5.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna mirëmban dosjet e personelit me të gjitha dokumentet e kërkuara nga rregulloret përkatëse.		Zgjidhur pjesërisht	
4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Ne rekomandojmë që Kryetari të përfshijë burime shtesë në regjistrimin, kontrollin dhe vlerësimin e asetëve të Komunës.			për t'u zgjidhur

4.6.3 Trajtimi i të arkëtueshmve	Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurojë një proces, i cili siguron që të arkëtueshmet janë të regjistruara mbi lëshimin e çdo fature dhe se shumat e mbetura janë përcjellë rregullisht.			Për t'u zgjidhur
5. Sistemi i auditimit të brendshëm	Ne rekomandojmë që Kryetari duhet të bëjë një Plan Veprimi që duhet zbatohet për të siguruar që puna e auditimit të brendshëm është bërë dhe raportuar mbi një bazë kohore dhe për të zgjidhur Rekomandimet e rezultuara, detajuar oficerët përgjegjës dhe afatin kohor për zbatim.			Për t'u zgjidhur

Shtojca III: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave tona

Të gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne rast të mospajtimit	Pikëpamja e KPMG
<p>2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF</p> <p>Burimi kryesor e i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance, i cili nuk përdoret për të regjistruar dhe raportuar gjithë shpalosjet të cilat nuk raportohen sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme. Këto shpalosje përfshijnë të hyrat nga gjobat, pagesat nga palët e treta, të arkëtueshmet dhe detyrimet kontigjente.</p> <p>Mospërputhjet e mëposhtme u identifikuan në pasqyrat financiare:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Numri aktual i punëtorëve në fillim të vitit 2013 sipas Nenit 22 tregon katër punëtorë më pak se listat e pagave dhe numri total i punëtorëve e tejkalon numrin e punëtorëve sipas ligjit të buxhetit për shtatë punëtorë në fillim të vitit dhe për një punëtor në fund të vitit. • Në Shënime 23-25 nuk janë dhënë detaje të mjaftueshme për arsyet e ekzekutimit të ulët të buxhetit, megjithëse Komuna ka dhënë sqarime për burimet e financimit dhe destinimin e fondeve përkatëse. • Janë përdorur klasifikime të ndryshme për shpenzimet për mallra dhe shërbime dhe për shpenzimet komunale sipas buxhetit fillestar në Nenin 13 dhe në Nenin 18, Shënimi 36. Kishte një diferencë prej 12 mijë EUR në klasifikim, ndërsa në total buxheti barazonte. Gjithashtu pagesat nga palë të treta në vitin 2012 ishin përfshirë të gjitha në Shënimin 12, ndërsa në Nenin 12 janë prezantuar në dy kategori të ndryshme. <p>Pasqyrat financiare nuk ishin përgatitur në gjuhën Serbe.</p> <p>Ka diferenca të vogla dhe rumbullakimi në disa shënime dhe disa</p>	<p>Pjesërisht</p>	<p>Në PVF figuron neni 19 , ndërsa në fillim të vitit 2013 kemi tejkallim për 3 punëtorë, kurse në fund të vitit 1.</p> <p>Konsiderojmë se janë dhënë shpjegimet kryesore për diferencat e paraqitura.apo shpalosje të mjaftueshme</p> <p>Dallimet prej 12,000 € janë për arsye të rishikimit gjashtë mujor të buxhetit (pra me rishim është aprovuar ky ndryshim)</p>	

formatime që mund të përmirësohen më tej për të siguruar një prezantim të mirë të pasqyrave.			
4.3 Ekzekutimi i buxhetit Ekzekutimi i buxhetit nuk ishte në nivelin e pritur. Ekzekutimi i ulët krahasuar me buxhetin final lidhet kryesisht me investimet kapitale dhe gjithashtu me kategoritë e tjera të shpenzimeve. Të hyrat aktuale vetanake janë realizuar në nivelin 67% të buxhetit për vitin 2013, dhe janë ulur me 5% krahasuar me të hyrat për vitin 2012.	Po		
4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake) <ul style="list-style-type: none"> • <i>Sistemi i faturimit.</i> Një sistem automatik i faturimit ekziston vetëm për të hyrat nga tatimi në pronë. Komuna nuk mban regjistra të faturimit për llojet e tjera të të ardhurave. Në vend të kësaj, janë regjistruar vetëm arkëtimet me para të gatshme nga të hyrat e tilla. • <i>Mbledhja dhe barazimi i të hyrave:</i> Përveç tatimit mbi pronën, leje biznesi dhe taksa në pronat me qera, Komuna nuk mban regjistra të ndarë ose ndonjë listë të të gjithë debitorëve sipas llojeve të ndryshme të taksave. Komuna nuk ka bërë ndonjë barazim formal të të hyrave të mbledhura me departamentin e kontabilitetit përgjatë vitit 2013. • <i>Anketimi dhe verifikimi i pronave.</i> Nuk është kryer anketimi i gjithë pronave të reja dhe as verifikimi i 1/3 së pronave ekzistuese të tatueshme siç kërkohet të verifikohet çdo vit konform Ligjit Nr. 03/L-204, UA Nr. 03/2011 për tatimin në pronën e paluajtshme • <i>Klasifikimi i të hyrave:</i> Komuna ka përdorur fletëpagesa të destinuara për 'Tatimin në pronë' për pagesa të kryera për 'Regjistrimin e veturave' në vlerën prej 20 EUR. Si pasojë, kishte diferenca mes këtyre dy kategorive sipas listave të pagesave dhe sipas regjistrimeve në free balance. 	Po	Tani jemi në proces të instalimit të një sistemi automatik të faturimit dhe regjistrimit të të hyrave vetanake	
4.5.1 Prokurimi <ul style="list-style-type: none"> • Gjashtë dosje të prokurimit ku përfshihen dosjet me nr. 	Po	Nuk ka komente	

<p>KA652/12/002/136, KA652/12/27/521, KA652/12/011/136, KA652/12/021/236, KA652/11/32/521 dhe KA652/11/27/521 me shumë totale të kontraktuar prej 336 mijë EUR dhe vlerë totale të paguar deri në fund të vitit 2012 prej 299 mijë EUR, janë nën hetime nga zyra e prokurorit publik dhe nuk na janë dhënë gjatë auditimeve për vitet 2012 dhe 2013. Ne nuk jemi në dijeni të arsyeve dhe statusit të hetimeve dhe as për rezultatin e mundshëm final. Nuk ka pasur komunikime zyrtare mes Komunes dhe organeve të hetuesisë në lidhje me këto raste gjatë vitit 2013.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prokurimi Nr. KA652/13/05/136: njoftimi për kontratë gabimisht tregon se procedura është 'e hapur', ndërsa sipas kodit të prokurimit dhe dosjes së tenderit procedura është 'Kuotim i çmimit i hapur'. Edhe pse sigurimi i tenderit është kërkuar në njoftim të kontratës, ne nuk na është ofruar sigurim i tenderit për fituesin. • Prokurimi Nr. KA652/12/44/221: një anëtar nga komisioni i vlerësimit nuk e ka nënshkruar raportin e vlerësimit. • Në prokurimet Nr. KA652/13/31/521, KA652/13/63/521 dhe KA652/13/75/136 kishte vonesat në kryerjen e punëve sipas planit dinamik. Komuna nuk ka zbatuar ndëshkime për këto vonesa, siç parashihej me kontratë. 			
<p>4.5.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit</p> <p>Çështjet e mëposhtme janë vënë re sa i përket projektit 'Ndërtimi i qendrës për komunitete', i bashkëfinancuar nga Komuna, 'Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF)' dhe 'Komisioni i Projektit Kacaniku i Vjetër (CP)':</p> <ul style="list-style-type: none"> • CDF ka organizuar procedurat e prokurimit dhe Komuna nuk ka dëshmi të procedurave të tilla për të mbështetur pagesën; • Pagesa është bazuar në kërkesën e CDF dhe faturën e CDF pa dokumente të tjera mbështetëse; <p>Gjithashtu, në një projekt tjetër të përbashkët Caritas Luxemburg ka</p>	Po		

<p>organizuar procedurat e prokurimit dhe Komuna nuk ka dëshmi të procedurave të tilla për të mbështetur pagesën. Pagesa është bazuar në marrëveshjen me donatorin pa dokumente të tjera mbështetëse. Komuna ka marrë pjesë me 83 mijë EUR në këtë projekt dhe gjatë vitit 2013 ka paguar një vlerë prej rreth 40 mijë EUR</p>			
<p>4.5.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)</p> <ul style="list-style-type: none"> • CPO të pagave për qershorin 2013 nuk janë nëshkruar nga zyrtari administrativ në një rast dhe nga zyrtari aprovues në 6 raste. • Për punëtorin me Nr. EM00052591 sipas akt vendimit rritja e koeficientit të pagës do të bëhej që nga 21 Marsi 2013, ndërsa në listën e pagave nga Ministria e Shërbimeve Publike rritja e koeficientit të pagës është reflektuar që nga muaji Maj 2013. • Për punëtorët me Nr. EM00099171 dhe EM00057871 nuk na është ofruar shpallja në gazetë për vendin e punës dhe dokumentimi i intervistimit të kandidatëve. • Për punëtorin me Nr. EM00130694 nuk na është ofruar dokumentimi i vlerësimit të performancës. • Për punëtorin me Nr. EM00019900 nuk na është ofruar kodi i etikës që duhej të ishte mbajtur në dosje. 	Po		
<p>4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale</p> <p>1. Neni 16 Shpалosja e pasurive</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për disa pasuri ekzistojnë paqartësi lidhur me të drejtat e pronësisë së Komunës apo të Agjencive të tjera Qeveritare të Kosovës dhe ka mungesë dokumentacioni për pronësinë e tyre. • Si pasojë e mungesës së dokumentacionit përkatës për matjen e një pjese të konsiderueshme të aseteve, Komuna ka kërkuar të masë këto objekte me vlerën e drejtë në bazë të një vlerësimi të kryer nga një komitet i brendshëm. Vetëm ndërtesat kryesore komunale që nuk ishin raportuar në periudhat e mëparshme u identifikuan dhe u 	Po		

<p>regjistruan. Vlerësimi ishte më i ulët se vlera e shpalosur në Nenin 16 për 918 mijë EUR dhe diferenca nuk ishte sqaruar ose barazuar. Pritet që në periudhat e ardhshme të regjistrohen edhe pasuri tjera që nuk janë ende në regjistrat aktualë të pasurive të Komunës.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komuna nuk ka një zyrtar të pasurisë dhe nuk ka të regjistruar asnjë pasuri në free balance gjatë vitit 2013. Komuna nuk ka përgatitur një listë të detajuar të lëvizjeve në vitet 2013 dhe 2012 për të mundësuar pajtimin e informatave të prezantuara në pasqyrat financiare dhe nuk ka mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës me informacione të tilla si data e blerjes dhe asgjësimit të aktivitetit, dhe zhvlerësimi për vitin. Si mungesë e këtij verifikimi, diferenca mes bilanceve të paraqitura në Nenin 16 për vitet 2012 dhe 2013, nuk barazon me shtesat totale për vitin 2013 të paraqitura në Nenin 12 me një diferencë të pasqaruar prej 1,436 mijë EUR. • Komuna nuk ka pranuar informacion të rregullt zyrtar nga Ministrinë gjatë vitit 2013 për pasuritë që mund të kenë realizuar këto Ministri në këtë Komunë gjatë viteve të mëparshme dhe në vitin 2013. Si pasojë Komuna mund të duhet të bëjë korrigjime të rëndësishme në të dhënat ekzistuese lidhur me pasuritë e financuara nga palë të treta në pasqyrat financiare dhe në regjistrin e mjeteve fikse në të ardhmen. 		<p>Tani komuna ka emëruar një zyrtarë të pasurisë dhe vetëm presim trajnimin dhe certifikimin e tij nga Thesari.</p>	
<p>4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale</p> <p>2. Pagesat nga palë të treta</p> <p>Free Balance nuk përdoret për të regjistruar pagesat nga palët e treta. Si rrjedhojë sistemet qendrore të informacionit në përdorim të Komunës, nuk sigurojnë të dhëna të plota financiare për këto pagesa. Në Nenin 12 Komuna ka shpalosur 764 mijë EUR pranime nga Ministrinë për investime kapitale. Komuna nuk posedon dokumente transferimi e pronësie për këto investime kapitale.</p>	<p>Po</p>		

<p>4.6.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve</p> <p>Shumica e llogarive të arkëtueshme të paraqitura në pasqyrat financiare lidhen me vitet e mëparshme. Komuna nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për të mbledhur këto shuma dhe nuk ka kryer analiza për vjetërsinë e tyre.</p>	Po		
<p>5 Sistemi i auditimit të brendshëm</p> <p>Megjithëse Komuna ka krijuar një Komitet Auditimi, ky i fundit ka mbajtur vetëm 2 mbledhje gjatë vitit dhe jo 3 siç kërkohet. Anëtarët e Komitetit të Auditimit janë punonjës të Komunës dhe si rezultat nuk e kanë të mundur të kryejnë përgjegjësitë e tyre me pavarësinë e duhur. Me datë 18 Nëntor 2013, Kryetari ka marrë vendim për të ndërruar kryetarin dhe anëtarët e Komitetit të Auditimit.</p>	Pjesërisht	<p>Anëtarët e Komitetit të Auditimit nuk janë asnjëri nga punonjësit e komunës.</p> <p>Kryetari nuk ka ndryshuar me asnjë vendim anëtarët e komitetit të auditimit.</p> <p>Drejtori i Njesisë së Auditimit në bazë të Ligjit për Auditim të Brendshëm nr.03/L-128 ,ka raportuar rregullisht :</p> <p>Menaxhmentin e lartë</p> <p>Komitetin e auditimit dhe</p> <p>Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm në MF</p>	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Raporti Vjetor Financiar

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2013

Neni 11. **DEKLARATË PËR PREZANTIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE**



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



Për: **Fatmir Plakiqi, Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit**

Nga: **Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar**

Data	29.05.14	Vendi	ASSEMBLË
Ni. org.		Numri	16-16363
	01	Shtojcë	X

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2013 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji për menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-048 dhe ligjin nr. 03/L-221 për ndryshim plotësimin e LMFPF dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e pasqyrave financiare të Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës të organizatës buxhetore - KOMUNA E KAÇANIKUT për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2013.

Ne konfirmojmë, për sa kemi njohuri dhe besim, që:

Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësinë apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.

Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me identifikimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta. Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.

Nuk ka llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2013.

Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullative të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare, në rast se do të shkeleshin.

Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare. Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose shpalosur në mënyrën e duhur.


Të gjitha huatë për palët e jashtme janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas rrethanave.

Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Komunat duhet të dërgojnë raportet te komisioni për buxhet dhe financa të Asamblesë Komunale.

